

I nderuar Kryeministër z. Haradinaj,

Që nga emërimi në këtë pozitë, jam trajtuar me shumë respekt si nga Ministri, anëtarët e Kabinetit dhe stafi tjetër i Ministrisë.

Por ajo që nuk ka ndodhur është bashkëpunimi, të cilin unë me aq ngulmë kam kërkuar. Nuk e di arsyen pse ka ndodhur kjo.


Deri me tani, përveç emërimit tim Koordinator Nacional Kundër Dhunës në Familje që automatikisht i takon zv. Ministrit të Drejtësisë dhe prezantimit në mbledhjet e qeverisë kur mungon Ministri, nuk më është ndarë as një sektor që ta mbikëqyr, udhëheq apo të jem pjesë e ndonjë grupi me qëllim që të jap kontributin tim.

I bindur që përvoja profesionale mund të jetë me shumë interes. Nuk e kuptoj arsyen e mos bashkëpunimit .

Pavarësisht kësaj unë kam arrit të kem agjendën time të punës dhe temat me të cilat me shumë përkushtim do të merrem.

Në takimin e fundit që kemi pasur, kam kërkuar të kem mbështetjen tuaj z. Kryeministër në trajtimin e disa temave që unë besoj fuqishëm se mund ta jap kontributin tim, e që do të jenë sukses për Qeverinë. Shumë shpejt do të ju prezantoj këtë material dhe besoj që të kem mbështetjen tuaj.

Me respekt!  
Naim Qelaj  
Zëvendësministër i Drejtësisë



Faqe 12 nga 12

Adresa: Rr. "Z. Haxhi Haxhinaxhi", Bl. "Nëntor" e Kufinjës, Tiranë, Shqipëri  
Telefon: 00355 79 48 88 88

<http://www.ks.gov.net/md-ks.org>

- Të gjitha projektet të jenë në harmoni me strategjinë kombëtare kundër dhunës në familje.

Angazhimi im si Zëvendës Ministër në Ministrinë e Drejtësisë, ka qenë i orientuar në arritjen e rezultateve në këto çështje:

- **E natyrës urgjente është rihapja e shtëpisë së sigurte ( Strehimores në Prishtinë ).** Deri më tani kamë shtyrë procesin për licencimin e strehimores që ka përfunduar, tani është faza e financimit që është detyrë e Ministrisë së Punës dhe Mërqinjës Sociale dhe që do të përfundoj shumë shpejtë.
- nga të gjithë anëtarët e grupit koordinues **Krijimi i data bazës për futjen e të dhënave të integruara në një bazë të vetme**, për rastet e dhunës së familje. Suksesi i arritur është, memorandumimi për mbështetje financiare më UN Women, e cila ka marrë për sipër që të heqë shpenzimet financiare për krijimin e kësaj data bazë dhe mirëmbajtjen e sajë deri në fund të vitit 2019, si dhe mbështetje financiare për pagesë të një zyrtari që do të trajnohet për menaxhimin e kësaj data bazë që do të jetë në pronësi të Ministrisë së drejtësisë.
- **Krijimi i mekanizmave koordinues në të gjitha komunat e Kosovës**, roli i të cilave do të jetë koordinimi i të gjitha veprimeve nga organet që merren me trajtimin e rasteve të dhunës në familje në realizimin e objektivave që janë përcaktuar sipas planit të veprimit në Strategjinë Kombëtare Kundër Dhunës në Familje.
- **Organizimi i punëtorive dhe Konferencës Rajonale që do të mbahet në Prishtinë** dhe qëllimi i sajë do të jetë promovimi i Kosovës në të arriturat e Qeverisë në fuqizimin e rolit të gruas në përgjithësi, respektimit të barazisë gjinore dhe rezultatet në luftimin e Dhunës në Familje
- **Harmonizimi i legjislacionit me vetë faktin që dhuna në familje do të sanksionohet si dispozitë e veçanta në Kodin Penale .**
- **Deri në fund të vitit 2018 , me Ministrinë e Arsimit** do të mundësojmë punësimin e 80 psikologeve – pedagogëve, siç është paraparë në strategjinë kombëtare.
- **Deri në fund të vitit 2018**, do të krijohen mekanizmat ligjorë dhe institucional në formimin e institucioneve që do të merren me trajtimin e kryerve të veprave të dhunës në familje.
- Të gjendet forma e financimit të qëndrueshëm të strehimoreve si nevojë që ka dalë nga takimet që kamë pasur me të gjithë anëtarët e grupit koordinues.
- Do të filloj zbatimin i rishikimit të Procedurave Standarde të Veprimit me qëllim të funksionalizimit të plotë

Temë e diskutimit në këtë takim ishte koordinimi ndërinstitucional i këtij mekanizmi, roli i zyrës së koordinatorit nacional, në koordinim dhe në adresim të çështjeve me prioritet.

Nga ky takim dolën, rekomandime si për nivelin qendrorë ashtu edhe për atë lokal sidomos:

- Fuqizimi i rolit të Qendrës për Punë Sociale me kuadro profesional
- Koordinimi në drejtim të mbledhjes së informatave të integruara në një bazë me qëllim që të mos ketë dallime në të dhëna statistikore dhe në informatat që sigurohen nga organet shtetërore

#### **Datë 03.04.2018**

Pjesëmarrje në mbledhjen e 39 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në mungesë të Ministrit z. Abelard Tahiri.

#### **Datë 04.04.2018**

Takim me anëtarët e grupit koordinues, Këshillin Prokuroria, Gjykatën e Apelit, Ministria e Kulturës, Ministria e Arsimit.

Në këtë takim u diskutua për nisjen e punës dhe punën që secili anëtarë duhet ta kryej për krijimin e data bazës.

Në ora 13:30h, takim me përfaqësuesen e UN Woman, në të cilin takim u diskutua, kërkesa e grupit punues për ndryshim dhe plotësim të Kodit Penal, në trajtimin e dhunës në familje si vepër penale dhe hartimit të një kapitulli të veçantë për këtë çështje.

#### **Datë 05.04.2018**

Vizitë në Akademinë e Sigurisë Publike në Vushtrri, vizita është realizuar nga ora 11:00h deri në 12:00h, ku kam marrë pjesë në një ligjëratë e drejtuar trajnerëve të Policisë Njësitit për ofrimin e mbrojtjes kundër dhunës në familje.

Në ora 13:30h kam marrë pjesë në komisionin e grupit të grave deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës ku është diskutuar në lidhje me projektligjin e Kodit Penal dhe rekomandimet që kanë dal nga grupi i rrjetit të grave të Republikës së Kosovës dhe grupi punues profesional.

#### **Datë 06.04.2018**

Në ora 9:00h, Takim me shefin e Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Temë e diskutimit ishte

- Harmonizimi i punëve në drejtim të formimit të data bazës për rastet e dhunës në familje, në koordinim të plotë dhe në harmoni me legjislacionin. Drejtori i këtij institucioni u pajtua dhe premtoi dhe do të ndër marr të gjitha veprimet me qëllim të respektimit të dy parimeve atë të transparencës për publikun e në anën tjetër edhe të respektimit të privatësisë si një e drejtë bazë e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Në ora 10:00h, takim pune me drejtorin e Qendrës për Punë Sociale në Prishtinë z. Vehbi Mujku Nga ky takim, u shkrua si çështje nevoja e hapjes sa më të shpejtë të strehimores në Prishtinë, rritjes së kapaciteteve njerëzore me staf profesional, për Qendrën për Punë Sociale në Prishtinë.

Në ora 11:00h, kam pas takim me znj. Igballe Rugova, nga rrjeti i grave të Republikës së Kosovës, me të cilën jemi dakorduar, që të bashkëpunojmë me rrjetin e grave dhe organizatat tjera ashtu që të punojmë në drejtim të :

- Krijimit të një kalendari të përbashkët dhe të koordinuar të aktiviteteve të shënuara

- Organizimi i takimit me grupin koordinues në Gjakovë, i cili do të mbahet më dt. 30.04.2018
- Të mbështetet zyra e koordinatorit, që do të financohet nga UN Women dhe më e rëndësishmja fillimi i punës së krijimit të data bazës për rastet e dhunës në familje.

Të njëjtën ditë është mbajtur takim me përfaqësues të kompanisë Kaktus të cilët janë të angazhuar nga UN Women për krijimin e data bazës.

Nga ky takim rekomandimet që dolën janë :

- Të mbahet takim me të gjithë anëtarët e grupit koordinues, për të kërkuar dhënien e informatave të nevojshme kompanisë kontraktuese
- Të nënshkruhet memorandum bashkëpunimi në mes të Ministrisë së Drejtësisë dhe partnereve që do ta financojnë këtë projekt
- Organizimi i një punëtorie ku do të diskutohen të dhënat që do të përfshihen në aplikacion të data bazës

#### Datë 29.03.2018

Takim me OSBE-në. me znj. Valentina Bejtullahu – Zyrtare e Programit/Ekipi për Barazi Gjinore OSBE, Misioni në Kosovë

Qëllimi i takimit:

- Njoftimi mbi funksionimin e OSBE në Kosovë
- Bashkëpunimi me Zyrën e Koordinatorit Nacional për zbatimin e Strategjisë Kombëtare

#### Rekomandimet:

Takimi ishte joformal ku Koordinatorin u njoftua mbi funksionimin e OSBE në Kosovë. Përfaqësuesja e OSBE tha se prioritetet e kishin Dhunën në Familje, themelimin e strehimoreve si dhe bashkëpunimin me policinë dhe prokurorinë e Kosovës. Si organizate kanë mbështetur ABGJ përmes mbajtjeve të trajnimeve me resurse njerëzore dhe profesionale, përmes intervistave të drejtpërdrejta, me tryeza diskutimi në mënyrë që të vërehen pengesat dhe ngecjet e DHF. Gjithashtu kanë monitoruar mbrojtësit të viktimave, mjek dhe infermier, mirëpo kanë hasur në vështirësi me policinë dhe prokurorinë. Pastaj kanë mbajtur edhe seanca informative me arsimtar dhe nxënës të shkollave fillore të ciklit të lartë, ku kanë ftuar psikologe dhe pedagog. Sa i përket strehimoreve u fol se ishin avokuesit me të zëshëm për hapjen e tyre, kanë mbajtur takime me kryetare komune ku teme kryesore ishin fondet, pra për një financim afatgjatë të strehimoreve. Shqetësimi ishte tek mbyllja e strehimores së Prishtinës, ku kishin ftuar hak tërësi kyç për të biseduar rreth zgjedhjes së këtij problemi. Gjithashtu është kërkuar të krijohet një grup ndër-institucional të mbështetur nga OSBE dhe të mbahen takime sa më të shpeshta të këtyre hak tërëve.

U diskutua edhe për hulumtimin i cili behet në të gjithë Evropën d.m.th. kudo që OSBE vepron. Pjesë e këtij hulumtimi janë edhe IPSOS dhe RrGK. Janë zgjedhur 80 gra dhe vajza për tu intervistuar.

#### Datë 30.03.2018

Pjesëmarrje në takim të organizuar nga mekanizmi koordinues në komunën e Gjakovës dhe kryetarit të Komunës z. Ardian Gjini.

Nga data 16.01.2018 e deri me datë 26.02.2018 nuk kam zhvilluar as një aktivitet, për shkak të gjendjes shëndetësore dhe lëndimeve që kam pësuar në aksident rrugës për në punë.

#### Datë 01.03.2018

Takimi me përfaqësues nga EULEX-I (4 përfaqësues), dhe nga ICITAP-I (1 përfaqësues).  
U diskutua për :

- Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje
- Raporti pasues i Policisë dhe Prokurorëve si përgjigje ndaj Dhunës në Familje
- Strehimoret

Në takim përfaqësues të EULEX informuan për të gjitha aktivitetet që kanë ndërmarr deri në këtë takim

#### Datë 08.03.2018

Pjesëmarrje në aktivitetin e Agjencia për Barazi Gjinore/ Zyra e Kryeministrit , ku kam paraqitur edhe raport lidhur me zbatimin e Strategjisë Kombëtare Kundër Dhunës në Familje .

#### Datë 12.08.2018

Pjesëmarrje si panelit në takimin e organizuar nga Rrjeti i Grave të Kosovës në prezantimit të gjetjeve të hulumtimit, ku kam diskutuar për rëndësin dhe rolin e Koordinatorit Nacional në luftimin e dhunës në Familje

Pjesëmarrës, Përfaqësues të ambasadës Norvegjeze, Prokurorisë së Shtetit, Këshillit Gjyqësor, etj.

#### Datë 28.03.2018

Takim me shefën e EULEX znj. Papadopoulo, me të cilën u diskutua për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me barazinë gjinore, dhunën në familje, puna që është bërë në këto dy segmente dhe detyrat që dalin në të ardhmen.

U diskutua edhe për sistemin gjyqësorë në përgjithësi dhe rëndësinë që ka në luftimin dhe parandalimin e dukurive negative, në fokus të drejtat e grave por edhe të viktimave në përgjithësi nga dhuna në familje.

Shfjja e EULEX, premtoj mbështetje të plotë që do ta ofroj deri në fund të mandatit të EULEX  
Pastaj

Takim me përfaqësues të UN Women, qëllimi i takimit ishte bashkërendimi i aktiviteteve në fushën e barazisë gjinore dhe mbrojtjes nga dhuna në familje.

U mor vendim që të rekomandohen këto çështje :

- Të fillojnë përgatitjen e organizimit për një konferencë rajonale, që do të mbahet në Prishtinë, ku do të prezantohen të arriturat e Republikës së Kosovës në avancimin e barazisë gjinore dhe parandalimit të dhunës në familje, krahasuar me vendet e rajonit.
- Organizimi i një punëtorie me partneret dhe donatorët.

- Përmasimi i kushteve në burgje sidomos
- Aktivizimi dhe funksionalizimi i njësive ekonomike
- Përmasimi i qendrave trajnuese,
- Problematika e kapaciteteve mbi nevojat e disa burgjeve psh. Në Dyz etj
- Është propozuar mbyllja e burgut të Prizrenit dhe në Pej.

Kam marr përsipër me iniciuar procedurën e ndarjes së lokacionit nga komuna e Prizrenit, lokacion që do të jetë i favorshëm. Gjithashtu do të angazhohem që në ministri të propozoj që të planifikohet ndërtimi i burgut të ri në Prizren, pasi që mbyllja e kësaj qendre të paraburgimit do të ishte shumë e dëmshme .

### Vizitë në Institutin e mjekësisë ligjore , u.d. i drejtorit Arsim Gerxhaliu.

Faktet me interes që me kanë rezultuar nga kjo vizitë;

- Deri ne vitin 2002 instituti ka funksionuar në kuadër të fakultetit të Mjekësisë
- Sipas ligjit, do të formohet institut dhe do të ketë 4 departamente ,
  1. Mjekësia ligjore ku janë para[a të jenë nen sektorët , kujdestarët, teknikët mjekësor, motrat forenzike, mjakët ligjorë,
  2. Departamenti për të zhdukurit , si departament që do të udhëheq bisedimet dhe komunikimin me Serbinë
  3. Sektori për ngritjen e kapaciteteve ,
  4. departamenti administrativ
- EULEX ka kapacitet aktual me 8 zyrtarë

Ndër të tjera më informoj edhe për .

- ICMP-ja merret me analiza të ADN-së , posedojnë mostrat e gjakut të familjareve dhe mostrat e mbetjeve mortore.
- 300 mbetje mortore janë të pa identifikuara sepse analizat me mostrat e 2.900 familjareve nuk janë përputhur. Ky problem ka ardhur si pasojë e punës që ka bërë tribuna li i Hagës me 4019 trupa të gjetur që janë varrosur pa analiza të mirëfillta por duke i trajtuar me metoda klasike dhe 2000 trupa vetëm mbi bazën e deklaratave nga dëshmitarët.
- Komisioni Qeveritar për personat e Zhdukur vepron mbi bazën e ligjeve të kualifikuara, pra të njëjtë me të mjekësisë ligjore dhe përzihet në kompetenca duke shkaktuar hutitë e mjegull.
- Grupi Punues për personat e pagjetur ka karakter komunikues me serbin
- E gjithë puna e komisioneve monitorohet nga BE dhe nga ambasada e Anglisë e të tje..
- Zgjedhja e drejtorit nënkupton edhe fillimin e implementimit të ligjit andaj duhet të zgjidhet sa më shpejt .

- Stafit që punon në këtë departament janë 3 zyrtar ligjor, 1 zyrtar për marrëveshje me jashtë, 4 përkthyes
- Ka nevojë për rritje të stafit, ky aktual nuk mjafton për vëllimin e punëve me të cilat ngarkohet

#### Datë 28.12.2017

Kam pritur në takim Kryetaren e Odës së Përmbauesve znj. Emine Sherifi – Lubeniqi  
Temë e takimit, informimi për punën e OPP dhe çështjet në interes

Përfundimet e nxjerra nga takimi :

- Në Kosovë aktualisht veprojnë 38 përmbaues
- Në përpilimin dhe hartimin e koncept dokumentit kanë marr edhe dy përmbaues
- Nuk janë përfillur sa dhe si duhet rekomandimet e nxjerra nga OPP
- Kërkesë e OPP-së ka qenë mbrojtja e pozitës së debitorëve që janë rast social dhe kategori tjera që janë në vështirësi. ( me plotësimin e ligjit është përmisuar )
- Nuk janë përfillur rekomandimet për mbrojtjen e të drejtave të përmbauesve, nuk është shqyrtuar imuniteti funksional
- Komisioni Disiplinore vepron vetëm në një shkallë, ( është interes që komisioni i parë të jetë brenda odës e e=komisioni nga Ministria të jetë si shkallë e dytë )
- Komisioni i MD-së kompensohet nga mjetet e OPP( kjo është e pa drejtë dhe ju paraqet vështirësi)
- Mjetet financiare nga ndëshkimet e përmbauese nga komisioni disiplinorë kur shqiptojnë gjobë në të holla, i arkëtohen Ministrisë.
- Sipas OPP-së ngarkimi si barrë kreditorit i shumës në emër të efikasitetit është i gabuar, duhet të ngarkohet debitori me këtë barrë.
- Përgjashtimi që organet shtetërorë të mos paguajnë taksë është gabim

U diskutuan edhe shumë çështje tjera, kryetarja e OPP-së më informoj që Ministri i ka premtuar që në mbështetje të Përmbauesve do të organizoj një takim me të gjithë përmbauesit, por deri me tani nuk e kanë informuar për këtë premtim.

#### Kam marr pjesë në hapja e qendrës së paraburgimit në Hjavali,

Pjesëmarrës ;

- Ministri i drejtësisë
- Ministri i Administratës Publike Mahir Jaggjillar
- Kryetari i Këshillit gjyqësor
- Kryetari i këshillit prokurorial

Hapja zyrtare, fjalime dhe koktej.

#### Datë 12.01.2018

#### Kam vizituar Shërbimin Korrektues të Kosovës, z. Sokol Zogaj

Tremat e diskutuara;

Faqe 6 nga 12

Adresa: Buzga Luan Haradinaj, Ish Njësia e Rilindjes, Eati 1-3-42  
Telefoni : 058 200 18 005

<http://www.ks.gov.net/md-ks.org>

Detyrat e departamentit janë:

- Hartimi i koncept dokumenteve dhe dokumenteve tjera që janë kusht për integrim evropian , konsultimi dhe këshillimi ndërministrorë e ndër sektoriale që dalin nga marrëveshja e MSA-së .
- Udhëheq mekanizmin për drejtës, siguri dhe liri, i organ qeveritar që udhëhiqet nga MD
- Është përgjegjëse për raportin e progresit, analizon dhe nxjerr vërejtjet dhe konkluzionet e dhëna në këtë raport.
- Është përgjegjëse për asistencën e huaj, nga shtete dhe nga organizata ndërkombëtare, deri tash kjo ndihmë financiarisht ka arritur vlerën 100.000.000 milion euro . Në investime në gjyqësor dhe në infrastrukturën përcjellëse.
- Ky departament ka hartuar numrin më të madh të projekteve në qeveri.
- Koordinimi i politikave , hartimi i strategjisë dhe i politikave ne ministri

#### Datë 18.12.2017

Takime pune me udhëheqësin e departamentit për shërbimin sprovës Bajram Bujupi , me udhëheqësin e departamentit për profesione të lira z. Elbasan Dervishaj, udhëheqësin departamentit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar z.Gazmend Citaku

#### Kam prit në takim me udhëheqësin e departamentit për shërbimin sprovues Bajram Bujupi

Më njoftoj për punën që bën ky departament, stafi përfshinë gjithsej 75 të punësuar, funksionon në 7 zyre regjionale zakonisht janë të sistemuar në objektet ku vepron Prokuroria e shtetit.

Pritet rritja e stafit diku për 10 persona .

Vështirësitë teknika ka në Mitrovicë.

Është rritur dukshëm shqiptimi i masave alternative.

#### Kam pritur në takim me udhëheqësin e departamentit për profesione të lira z. Elbasan Dervishaj

Me njoftoj se stafi përbëhet prej 5 personave , nuk janë të mjaftueshëm

Ligjet që rregullojnë fushat e profesioneve të lira janë dërguar në parlament për tu proceduar në votim

Inspektimi i profesioneve te pavarura bëhet nga komisionet e caktuar nga ministri nuk janë të përhershme kjo paraqet problem për inspektim të mirëfillta.

#### Kam pritur në takim me udhëheqësin departamentit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar z.Gazmend Citaku

- Shumë komunikatave, i formuar len përshtypjen që është shumë i përgatitur në punën që bën.



- Aspekte që kanë të bëjnë me ndryshimin e ligjit për Noterin, sidomos kufizimet që parasheh ky ligj në punët që janë profesionale për avokatin, autorizime, kontratat etj
- Mungesa e anëtarit të OAK-së në Këshillin Gjyqësor dhe në Këshillin Prokurorial të Kosovës, kushtet që janë pacaktuar që anëtari në këto këshille nga OAK-ja duhet ta pezulloj licencën dhe pagesa duhet të jetë nga vetë Oda janë kushte që kanë ndikua mos me u përfaqësua oda në këto dy institucione .
- Ndryshimi i nenit 86 i Ligjit të Procedurës Kontesti orë( e drejta që palët me u përfaqësua nga persona që nuk janë avokat dëmton sigurinë juridike të palës, dëmton edhe avokatët në imazhin e tyre po edhe është ndërhyrje në punën e tyre)
- Përpilimi i propozimeve për përmbardim nga përmbarduesit
- Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 05/142 i dt. 19.04.2017, konsiderohet si ndërhyrje në punën e Odës e gjithashtu kjo çështje është pengës për punën e mëtejme.
- Mungesa e OAK-së në Komisionin për provimin e jurisprudencës konsiderohet e pa drejtë nga OAK.

#### **Takim pune me udhëheqësin e Departamentit Ligjor z Ardian Bajraktari**

Në këtë takim jam informuar për rolin dhe detyrat e këtij departament në drejtim të :

- Hartimi i akteve ligjore dhe nënligjore
- Ofrimi i këshillave dhe konsulentë në hartimin e ligjeve dhe akteve nënligjore
- Harmonizimi i akteve nënligjore me dhe ligjore

Në të ardhmen u akorduar që të kemi bashkëpunim dhe të angazhohem në grupet punuese ku konsideroj që mund të kontribuoj. U informova që aktualisht funksionojnë 2 grupe punuese për hartimin e ligjeve, janë në procedurë 7 Projekt ligje , 5 akte nënligjore, 4 projektligje janë në fazën e konsultimeve , si dhe dy projektligje për ratifikimin e marrëveshjeve për bashkëpunim juridiko ndërkombëtar.

#### **Me datë 15.12.2017**

Kam marr pjesë në Mbledhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, në mungesë të ministrit Abelard Tahiri.

Në mbledhjen e qeverisë prej detyrave në raport me ministrinë Drejtësisë ishte vetëm ;

- Kërkesë e veçantë doli për plotësimin e materialit për ministrit përkatëse që do të jetë pjesë e raportit të Qeverisë për , materiali na u dorëzua në fillim të mbledhjes.

#### **Takim me udhëheqësin e Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim i Politikave, z.Lulzim Beqiri**

Qëllimi i takimit njoftim për funksionimin e këtij departamenti.

Stafi prej 5 personash, drejtori dhe 4 zyrtar,

- Nuk ka pas lëvizje brenda stafit,
- Një zyrtarë është larguar vendi i tij nuk është plotësuar

Faqe 4 nga 12

Adrese: Rruga e Jani Haxhiutaj, Ish Ndërtesa e Rëmbodjes, Kati 1-40

Telefon: 045 260 08 065

<http://www.ks.gov.net/md-ks.org>

- Stafi mbështetës i pamjaftueshëm (janë të punësuar vetëm 3 Asistent- zyrtar ligjor)
- Mesatarja e përfaqësimeve sipas statistikave është 109.6 seanca në javë, që është kuat shumë e lartë dhe e pa përballueshme për stafin
- Lëndë aktive janë mbi 15.000 lëndë të natyrave të ndryshme që tregon se është e domosdoshme rritja e numrit të avokatëve dhe personelit mbështetës.

**Për ta sanuar këtë gjendje dolën këto propozime për të ardhmen :**

- Transferimi i avokateve Komunale në Avokatin e Shtetit, në mbështetje me ligjin e Avokatit të Shtetit
  - Implementimi – zbatimi i ligjit për avokatin e shtetit, duke plotësuar ligjin aktual mbi bazën e përvojës së deritashme .
  - Të ndalohet Përfaqësimi i organeve shtetëror pa autorizimin e avokatit të shtetit
  - Nxjerrja dhe miratimi i akteve nënligjore për zbatimin e plotë të ligjit për avokatin e shtetit
  - Trajnimi i vazhdueshëm ligjorë të stafit - avokatëve të zyrës së avokatit të shtetit
  - Rritjen e stafit si në qendër ashtu edhe për shtrirje territoriale sipas organizimit të pushtetit lokal dhe të gjyqësorit
  - Përzgjedhja e avokatëve që do të profilizohen për përfaqësime në arbitrazhe, si një nga pikat më të dobëta të përfaqësimit institucional.
- Për zbatimin e këtyre konkluzioneve të nxjerra është planifikuar punë sistematike në bashkëpunim me të gjithë organet vendimmarrës dhe ligje zbatues të Ministrisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës

**Me datë 14.12.2017**

Takim pune me z. Ylber Topalli Kryeinspektor i Ministrisë së drejtësisë dhe z. Ram Arifaj Inspektor dhe me përfaqësues të Odës së Avokatëve të Kosovës si dhe Drejtorin e Departamentit Ligjorë në Ministrinë e Drejtësisë z. Ardian Bajraktari.

Takimi me z. Ylber Topalli Kryeinspektor i Ministrisë së drejtësisë dhe z. Ram Arifaj Inspektor është realizuar me qëllim të informimit për situatën e këtij institucioni me shumë rëndësi.

Konkluzionet e nxjerra ishin ;

- Numri i inspektoreve që aktualisht janë të angazhuar në këtë sektor janë 6 dhe Kryeinspektori ( është mjaftueshëm për të përmbushur detyrat që kanë)
- Mirëpo mungon Stafi mbështetës.

**Takim me kryetarin e Odës së Avokatëve të Kosovës**

Në takim prezent ishte edhe Yll Zeka Drejtor Ekzekutiv i OAK-se

Temat që janë diskutuar kryesisht ishin për punën, rolin, sllidat e OAK-së ,

Gjetja e mënyrës së bashkëpunimit ndërinstytucional.

Nga ky takim si tema për diskutim për të ardhëm dolën të jenë :

Për: z. Ramush Haradinaj, j Kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës

I nderuar z. Kryeministër Haradinaj

**Ju raportoju si në vijim;**

- Me vendimin e kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 224/2017, të datës 04.12.2017, jam emëruar zëvendësministër i Ministrisë së Drejtësisë .
- Me datë 06.12.2017, kam pranuar detyrën dhe jam paraqitur në zyrë në Ministri.
- Me vendim të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, dhe të Ministrit të Drejtësisë nr. 12/2018 të datës 31.01.2018, jam emëruar Koordinator Nacional Kundër Dhunas në Familje

Me qëllim që të pasqyroj krejt angazhimin tim nga pranimi i detyrës po paraqes në formë kalendarike tërë rrjedhën e aktivitetit tim ;

Nga data 06.12.2017-10.12.2017, kanë vazhduar procedurat e sistemimit të zyrës, qasjes në internet, telefonit, kompletimi i stafit dhe punëve tjera teknike.

**Datë 11.12.2017**

Kam pasur takim me Kabinetin e Ministrisë

Qëllimi i takimit ka qenë informimi për agjendat dhe planifikimi për të ardhmen në drejtim të:

- Harmonizimi, ndryshimi dhe plotësimi i legjislacionit
- Rishikimi funksional i sistemit të drejtësisë
- Efikasiteti i zbatimit të sanksionit penal
- Rritja e kapaciteteve për bashkëpunimin juridiko ndërkombëtar
- Funksionalizimi i institutit të mjekësisë ligjore.

**Datë 13.12.2018.**

Nga data 13.12.2017 kam realizuar takime me të gjitha departamentet në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe agjencitë e saj


Qëllimi i këtyre takimeve ka qenë informimi për detyrat, angazhimet, të arriturat, sfidat e problemet me të cilat ballafaqohen, si dhe me propozimet për zgjidhjet e mundshme .

Takimet e realizuara janë :

Me datë 13.12.2017, takim me Avokatin e Shtetit z. Hestet Mazrekaj udhëheqës i Avokatisë së Shtetit. Takimi është realizuar me qëllim të informimit për situatën e këtij institucioni me shumë rëndësi.

**Konkluzionet e nxjerra ishin :**

- Numri i vogël i avokatëve ( vetëm 6 avokat me provim të jurisprudencës që përfaqësoj të gjitha lëndët )



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKI KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA ZRYE E Kryeministrit - PREDPRAMIRJA - DEPT. OF THE PRIME MINISTER SEKTORI I ARRIVËS - SEKTOR ARCHIVE - ARCHIVE SECTOR	
Kopim Nr. Copy No. 01	No. Prirje Prirje No. 1059/111
No. Datave By - numera No pages 2	Data: Datum: Date 11/04/2018 RP
Prishtinë/a	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the Secretary General

DATE/A:	10.04.2018
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Kryeministrin e Qeverisë së Kosovës z. Ramush Haradinaj
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Zyrës së Kryeministrit
NGA/OD/FROM:	Zëvendësministri i Drejtësisë Naim Qelaj
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport i punës për periudhën 04.12.2018-10.04.2018

I nderuar Kryeministër i Republikës së Kosovës z Haradinaj

Po ju paraqes raport të përmbledhur të aktivitetit tim që nga emërimi zëvendësministër në Ministrinë e Drejtësisë, si në vijim ;

## **RAPORT**

I punës dhe angazhimit të zëvendësministrit të Drejtësisë Naim Qelaj

Hartuar nga: Zëvendësministri i Ministrisë së Drejtësisë Naim Qelaj

Faqe 1 nga 12



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada – Government**  
**Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice**

- 1. Zv. Vesna Mikiq, ( nuk e ka dorëzuar )**
- 2. Zv. Naim Qelaj, ( dorëzuar me datë 11.04.18 – 12 faqe )**
- 3. Zv. Fadil Nura, (është emruar që një muaj)**